

Ministria e Drejtësisë  
Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas



Qendra  
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. Prot. 347

Datë 03.02.2023

Nr. Prot. 109

Datë 3/02/2023

## MARRËVESITJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET:


**DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS (DNJF)**

*Përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Ergys QIRICI*


**DHE**

**QENDRËS "SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË" (TLAS)**

*Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Znj. Raimonda BOZO*



Ministria e Drejtësisë  
Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas



Qendra  
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Lidhur sot më datë 31/02/2023

#### Ndërmjet

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që më poshtë do të referohet si DNJF, që ka si objekt të veprimtarisë së saj zbatimin e ligjit nr.111/2011 *“Për ndihmen juridike te garantuar nga shteti”* nga i cili burojnë të gjitha detyrimet funksionale, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë në drejtim të përmbushjes së misionit madhor *“Garantimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët si një e drejtë themelore me karakter kushtetues”*;

#### Dhe

Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, që më poshtë do të referohet si TLAS, që është organizatë jofitimprurëse e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, regjistruar në formën e Qendrës me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me mision *“Përmbushjen e nevojave sociale dhe ligjore të individëve vulnerabël; edukimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut dhe nxitjen e nismave për përmirësimin e legjislacionit në funksion të forcimit të demokracisë në Shqipëri”*;

#### Neni 1

#### OBJEKTI

Kjo marrëveshje ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe mënyrave sipas të cilave DNJF dhe TLAS do të zhvillojnë marrëdhëniet e ndërsjella, në kuadër të zbatimit në bashkëpunim të aktivitetëve dhe projekteve të përbashkëta në fushën e ndihmës juridike falas.

#### Neni 2


#### QËLLIMI

Kjo marrëveshje ka për qëllim fuqizimin e shtetit të së drejtës përmes rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët dhe promovimit të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm:

#### Neni 3

#### FUSHA E ZBATIMIT

Kjo marrëveshje konsiston në:



Ministria e Drejtësisë  
Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas



Qendra  
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

- Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të zbatimit të legjislacionit me fokus çështjet e mbrojtjes së grupeve dhe individëve të marginalizuar;
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese në nivel kombëtar si fushata advokimi, udhëgjyqjesimi të shtetasve, seanca informuese dhe shkëmbim experience me grupet e synuara dhe publikun në tërësi me synim garantimin më të mirë të të drejtave themelore të njeriut;
- Realizimin e takimeve të përbashkëta në institucionet dhe strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve me fokus kategoritë përfituese të ligjit për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti me qëllim informimin dhe përmirësimin e shërbimit ndaj grupeve vulnerabël;
- Referimin e ndërsjellë për trajtimin e rasteve strategjike si personat pjesë e një grupi të caktuar nga minoriteti, personat me aftësi ndryshe, të moshuarit, gratë e fëmijët e dhunuar, që kanë nevojë të mbështeten falas me ekspertiza të specializuara;
- Organizimin e përbashkët të aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të qendrave të ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në të gjithë territorin si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë me aktorët e tjerë të interesuar në fushën e rritjes së aksesit në drejtësi të qytetareve dhe jo vetëm.

#### Neni 4

#### KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- Palët do të komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme për të organizuar aktivitete të përbashkëta, për të konsultuar metodologjinë e përfaqjes gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe problematikave që hasen dhe duhen evidentuar e konsultuar;
- Mënvra e komunikimit do të jetë përmes teknologjisë: emailit, telefonave, dhe e drejtpërdrejtë përmes takimeve dy palëshe me secilën qendër shërbimit të ndihmës Juridike parësore si dhe me grupin aktorëve pjesë e rrjetit të shërbimeve ndaj qytetarëve në nivel lokal;
- Palët do të caktojnë secila një person kontakti, përgjegjës për të respektuar komunikimin sistematik për zbatimin konkret të marrëveshjes shkëmbimin e informacioneve;

#### Neni 5

#### KOHËZGJATJA

- Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nëshkrimit të saj nga palët dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundim të autorizimit të qendrës TLAS nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për periudhën 2022-2024.



Ministria e Drejtësisë  
Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas



Qendra  
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

- Në momentin e rinovimit të autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për periudhën 2024-2026, nëse nuk ka njoftim nga palët, kjo marrëveshje quhet e automatikisht e rinovuar.
- Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar me shkrim 60 ditë përpara.

#### Neni 6

#### DISPOZITA TË FUNDIT

- Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.
- Marrëveshja hartohet, nënshkruhet dhe protokollohet në 2 (dy) kopje, secila palë mban 1 (një) kopje origjinale;

Për:

DREJTORINË E NDIHMËS  
JURIDIKE FALAS

Drejtor i Përgjithshëm  
Z. Ergys Qirici



Për:

QENDRËN "SHËRBIMI  
LIGJOR FALAS TIRANË"

Drejtor Ekzekutiv  
Zj. Rajmonda Bozo

